

**Njoftim për shorteun publik të datës 09.01.2025 me objekt shpërndarjen / caktimin, midis përfituesve nga procesi i rindërtimit, i banesës kolektive nr.1&3 Rruga “Lura”, dhe nr. 15&23 rruga “Ahmet Dakli”, Njësia Administrative nr.5, Durrës .**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 13.10.2021 Për disa shtesa në vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 138, datë 28.10.2021, “Për miratimin e Rregullores për procedurat e zhvillimit të shorteut manual në bashkinë Durrës në kuadër të rindërtimit”,

Bashkia e Durrësit njofton përfituesit nga programi i rindërtimit se shorteu publik me objekt shpërndarjen / caktimin, midis përfituesve nga procesi i rindërtimit, i banesës kolektive nr. 1&3 Rruga “Lura”, dhe nr. 15&23 rruga “Ahmet Dakli”, Njësia Administrative nr.5, Durrës do të zhvillohet më datë 09.01.2025 në sallën e Këshillit Bashkiak Durrës, pranë Bashkisë Durrës, kati II duke filluar nga ora 11:00.

Nëpërmjet këtij njoftimi thirren të gjithë përfituesit sipas listës bashkëlidhur.

Mosparaqitja në këtë shorte e personave përfitues i heq të drejtën e ankimimit apo pretendimeve lidhur me rezultatet e këtij shorteu publik.

Personat përfitues në pamundësi për të qenë pjesmarrës në këtë shorte publik mund të përfaqësohen me prokurë. Në këto raste zbatohen dispozitat ligjore të përfaqësimit.

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET</b>
1	MUHARREM FERIZOVIKU	3+1
2	ALBERT VLASH CURRI VLASH CURRI, ERNEST CURRI, JUSTIN CURRI	2+1
3	XHEVDET KACMOLI, VILMA KACMOLI, ORNELA KONDAKCIU	3+1
4	QANI XHABLI	3+1